



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.03.2025
Numër Protokolli: 1959/2025

A.nr. 153/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe *Ardita Haxhnikaj-Demi*, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.153/2025 të datës 21.01.2025 të parashtruar nga ankuesi A.G, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.135/2025, e datës 21.01.2025, e parashtruar nga ankuesi A.G.

II. Mbetet në fuqi, Njoftimi me numër protokolli 14-111/01-0168389/24 i datës 23.12.2024, i Sektorit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën “*Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime*”.

A r s y e t i m

Ankuesi A.G (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 21.01.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 153/2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015420, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime*”, në Komunën e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit, më datë 11.02.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokoli 1515/2025, të datës 07.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.153/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 399/2025 të datës 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Konkursin me numër reference RN00015420 të datës 11.10.2024; Njoftimin e datës 13.11.2024; Njoftimin e datës 03.12.2024; Njoftimin e datës 19.12.2024; Njoftimin përfundimtar me numër protokoli 14-111/01-0168389/24 të datës 23.12.2024; E-mailin e datës 06.02.2023; Vendimin me numër 14-112/01-15010/23 të datës 01.08.2023; Vendimin me numër 14-112/02-0133832/24 të datës 11.10.2024; Vendimin me numër 14-112/02-43522/24 të datës 29.03.2024; Vendimin me numër 14-112/02-0201950/23 të datës 04.10.2023; Vendimin me numër 14-112/02-139255/24 të datës 05.07.2023; Vendimin me numër 14-112/02-68297/23 të datës 31.03.2024; Vendimin me numër 14-112/02-276598/22 të datës 28.12.2022; Vendimin me numër 14-112/02-207283/22 të datës 30.09.2022; Vendimin me numër 14-112/13-155969/22 të datës 05.07.2022; Vendimin me numër 14-112/02-74990/22 të datës 05.04.2022; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2025; Vendimin me numër 14-020/04-0152054/24 të datës 15.11.2024; Akt emërimit 01 Nr.112-799 të datës 01.02.2017; Akt emërimit Nr.01-112-241 të datës 08.02.2023; Akt emërimit 01 Nr.112-19 të datës 18.12.2019; Akt emërimit 01 Nr.112-1154 të datës 25.06.2019; Akt emërimit Nr.01-112-1231 të datës 10.08.2023; Akt emërimit Nr.01-112-517 të datës 01.01.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 23.12.2024; Formularët e vlerësimit të eses dhe eset të datës 16.12.2024; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 23.12.2024; Aplikacionin e ankuesit të datës 01.11.2024, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidati A.B të datës 07.11.2024, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, ***është e pabazuar, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komuna e Prishtinës, më datë 11.10.2024 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00015420, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese ” *Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime*”, me afat aplikimi nga data 12.10.2024 deri me datë 10.11.2024.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë shtatë (7) kandidatë, ku prej tyre tre (3) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin A.H, i cili i është nënshtruar testimit me shkrim në të cilin ka arritur t'i mbledh 49.6 pikë, nga rrjedh se ankuesi nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit atë të intervistës me gojë.

Spektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 23.12.2024 ka publikuar Njoftimin me numër protokollit 14-111/01-0168389/24, nga i cili njoftim rezulton se kandidati A.B, me gjithsejtë 87 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi. është shpallur kandidat fitues për pozitën *Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime* në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës.

Ankuesi, kundër njoftimit të lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore për shkelje të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe Ligjit Nr.03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës, andaj i njëjti kërkon aprovimin e ankesës dhe anulimin e njoftimit përfundimtar.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*", lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00015420, për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese *Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime* dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Kërkesat Specifike:* *Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i Ndërtimtarisë-Drejtimi Gjeodezi; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale*, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale të sapo theksuara janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/3 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën e Drejtues i Ulët.

Rrjedhimisht, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimit ankimor të ankuesit A.G, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e*

kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim:
2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Tutje, me qëllim të shqyrtimit meritorisht të pretendimeve ankimore të parashtruar nga ankuesi, dhe konstatimit se kandidatët për emërimin në këtë pozitë të kategorisë së ulët drejtuese janë vlerësuar nga Komisioni profesional, Kolegji i Këshillit, ka analizuar përbërjen e Komisionit të Pranimit dhe se nga analizimi i provave të lëndës, gjegjësisht bazuar në Vendimin me shifër 14-020/04-152054/24 të datës 15.11.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ka konstatuar se përbërja e Komisionit, është në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 45, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunës/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.; dhe në pajtim me nenin 22 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ngase thënë më konkretisht për vlerësimin e kandidatëve për pozitën lirë të punës Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime, kanë marrë pjesë këta anëtarë të cilët faktikisht janë nëpunës civil të Komunës së Prishtinës : znj. J.M-K, e cila sipas Akt emërimit 01 Nr.112-799 të datës 01.02.2017 mbanë pozitën e punës Udhëheqëse e Sektorit të Mjedisit dhe Ofiçencës, ndërsa sipas Vendimit me numër 14-114/01-00666634/24 të datës 23.05.2024; znj.N.K, e cila sipas Akt emërimit Nr.01-112-241 të datës 08.02.2023, mbanë pozitën e punës Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmi; z. R.Th, i cili sipas Akt emërimit 01 Nr.-112-19 të datës 18.12.2019, mbanë pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit; z. R.B, i cili sipas Akt emërimit 01 Nr.01-112-1154 të datës 25.06.2019, mbanë pozitën e punës Zyrtar për Gjeodezi; si dhe znj. J.K, e cila sipas Akt emërimit Nr.01-112-517 të datës 01.01.2023, mbanë pozitën e punës Zyrtare e Lartë e Personelit.*

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore tjera ankimore i'u referua legjislacionit në fuqi, respektivisht Nenit 44 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Nenit 9 ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është*

deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim....., dhe se nga analizimi i shkresave të lëndës kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit rezulton se vlerësimi i testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, ndërsa nga provat e pranuar nga ankuesi, si dhe organi i punësimit, rrjedh se ankuesi ashtu sikurse kandidati i përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, mirëpo ankuesi në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledh vetëm 49.6 pikë, respektivisht 32 pikë nga përgjigjet për pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë dhe 17.6 pikë prej 20 pikëve sa ishte maksimumi i pikëve për esenë me shkrim, nga rrjedh se i njëjti nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e kalueshmërisë dhe rrjedhimisht për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistën me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, ashtu që për sa më sipër nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se organi përkatës i punësimit gjegjësisht Komisioni i Pranimi në këtë procedurë të rekrutimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të pretenduara nga ankuesi, ngase të njëjti nuk i është cenuar apo mohuar ndonjë e drejtë nga kjo procedurë rekrutimi, përkundrazi i njëjti nga Komisioni përkatës për përgjigjen e esesë është vlerësuar me më së shumti pikë nga gjithë kandidatët tjerë pjesëmarrës.

Ndërsa, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit dhe duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e cila ka hyrë në fuqi 28.02.2024, ku përcaktohet se: Paragrafi 5 i nenit 9 të Rregullores bazike ndryshohet si në vijim: Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publikë që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen

për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit., Kolegji sjellë në vëmendje se sipas këtij përcaktimi ligjor pyetjet e testit me shkrim në rastin konkret është dashur ti përpiloj dhe i ka përpiluar Komisioni i Pranimit, dhe se përgjigjet për pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen automatikisht nga sistemi të cilin e menaxhon DMZP/MPB, ashtu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara ngase me asnjë dëshmi nuk mund të vërtetohen pretendimet tij se i njëjti nuk është vlerësuar meritorisht nga Komisioni i Pranimit.

Tutje, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedure rekrutimit dhe duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore, ka analizuar aplikacionin e kandidatit fitues A.B, të datës 07.11.2024, nga i cili rezulton se i njëjti si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.622 të datës 28.08.2012 të lëshuar nga “Universiteti i Prishtinës”, Fakulteti i Ndërtimatarisë dhe Arkitekturës, me anë të cilit dokument dëshmohet se i njëjti më datë 29.05.2012 ka mbaruar studimet themelore universitare në Departamentin e Gjeodezisë dhe ka fituar titullin Bachelor i Gjeodezisë; rrjedhimisht me këtë rast i njëjti dëshmon se ka plotësuar kriterin arsimor të përcaktuar me konkursin e lartë cekur, ndërsa po ashtu ka bashkangjitur edhe Diplomën me numër 061-10/16 të datës 19.10.2016 të lëshuar nga “Kolegji ESLG”, përmes së cilës dëshmohet se kandidati A.B, më datë 05.10.2016 ka fituar titullin Master i Arteve në Juridik dhe Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastrukturës.

Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës tre (3) vjeçare të punës profesionale, kandidati në fjalë ka bashkangjitur Akt emërimit 01-112-984 të datës 28.08.2013, mbi të cilin dokument zyrtar dëshmohet se me datë 01.09.2013 është emëruar dhe ka filluar punën në pozitën e punës „Zyrtar i Lartë për Gjeodezi” në Drejtorinë e Financave dhe Pronës në Komunën e Prishtinës, gjithashtu i njëjti ka bashkangjitur edhe një numër të konsiderueshëm të certifikatave nga kurset dhe trajnimet e përfunduara, si dhe licenca të lëshuar nga Institucionet Qendrore të Republikës së Kosovës.

Andaj, bazuar në të gjeturat e sipër theksuara, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidati A.B, ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, të përcaktuara me shpalljen e konkursit me numër Reference RN00015420, të datës 11.10.2024, për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime* në Komunën e Prishtinës, dhe duke qenë se i njëjti ka kaluar me sukses testin me shkrim me gjithsejtë 58.6 pikë dhe intervistën me gojë me gjithsejtë 28.4 pikë duke arritur kështu gjithsejtë 87 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi, dhe si rrjedhojë i njëjti ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidat fitues, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Kolegji i Këshillit, duke bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit me numër

protokolli me numër protokoli 14-111/01-0168389/24 të datës 23.12.2024, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën *Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime* në Drejtorinë e Pronës, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimit me numër protokoli 14-111/01-0168389/24 i datës 3.12.2024, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime*, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.153/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.G;
- Sektorit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.